Pershendetje.

Ne vijim te komentit te mepareshem per kontributin e profesioneve te lira, po paraqes me poshte faktet e derisotme dhe propabilitetin e neserm per kontributin e sigurimeve shoqerore per profesionet e lira.

Faktet:

1.Ndryshimi i ligjit per sigurimet shoqerore

LIGJ Nr. 144/2015 date 17.12.2015
PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në nenin 6, "Mbrojtja e detyrueshme", pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji.".

Në nenin 9, "Llojet e kontributeve për t'u paguar", pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, për- fshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, si dhe kriteret e përcaktimit të saj, nga paga minimale deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave.".

2.Ndryshimi i ligjit per Mbledhjen e Kontribeve dhe Sigurimeve

LIGJ Nr. 143/2015 date 17.12.2015
PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9136, DATË 11.9.2003, "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në nenin 6, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përçaktuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9, të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.".

Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës,

brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pagës, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.".

3.VKM per Sigurimet e profesioneve te lira (I pritshem)

KOMENTI IM:

Ne Vendimin e KM qe pritet te dale se shpejti, do te percaktohen pagat per profesionet e lira per efekt te llogaritjes se sigurimeve shoqerore sic e prcakton ligji i mesiperm.

Rreth ketij vendimi, duke qene se kam marre nje njohje paraprake, po parashtroj disa pika qe jane bere edhe debat nga ana ime me JU, ne projektin e para disa muajve.

1.Pagat e reja mendohet te ndryshohen nga dy fish ne trefish sipas kategorive.

Psh.per Avokatet (EKR, KM, Noter) pritet te varioje nga rreth 50.000 leke ne Tepelene, ne rreth 60.000 leke ne Durres dhe 75.000 leke ne Tirane

2.Pagat e reja do te kene kuptimin e pages minimale, qe do te thote se pagat nen keto nivele, do te rivleresohen.

3.Pagat e reja perseri per shpenzime, nuk do te njihen, pasi vazhdon interpretimi qe jane vetem per efekt te sigurimeve.

4.Per personat e familjes do paguhen sigurimet mbi bazen e pages minimale si deri me sot.

5.Ne ato raste kur Eksperti merr ne pune gruan, djalin dhe nje person tjeter paga e tij psh. ne Tepelene prej 50.000 lekesh rrite me 3% per cdo person pra 3x3=9% dhe paga per llogaritjen e kontributeve behet 54.500 leke deri te kufiri maksimal.

6. Ne ato raste kur Eksperti merr ne pune dy stazhiere me kohe te pjeseshme paga e tij psh. ne Tepelene prej 50.000 lekesh rrite me 2% per cdo person pra 2x2=4% dhe paga per llogaritjen e kontributeve behet 52.000 leke deri te kufiri maksimal.

7.Per profesionet e lira qe fillojne rishtaz, mendohet te kete stimulim ne zbritje me 30% per 3 vitet e para dhe 15% per 3 vitet e tjera.

8.Per rastet kur nje specialist i vetepunesuar njekohesisht eshte dhe i punesuar diku, mendohet te kete nje filter per pagimin e kontributit me pagen minimale.

9.Per pensionistet e vetepunesuar te vetem nuk ka pagese per sigurime, ndersa kur ka te punesuar, qofte edhe gruan do te paguaje per veten e tij, sigurime mbi pagen minimale.

Per piken e fundit qe eshte dhe ne ligjin e mesiperm, une do te beja nje paralelizem:

Psh.

- Nje Avokat (meqenese ne projekt eshte marre shembulli i Avokatit) pensionist i vetepunesuar i vetem realizon le te themi nje xhiro maksimale. Te biznesit te vogel prej 8.000.000 leke nuk paguan sigurime fare.
- Nje mesues pensionist qe punesohet ne nje shkolle private dhe merr le te themi 30.000 leke ne muaj, pervec pensionit duhet te paguaje sigurime mbi pagen minimale 22.000 leke.

Nxjerrja e konkluzionit mbetet ne gjykimin e gjithsejcilit.